



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 2
Prishtinë, më 17 tetor 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Verica Çaraniq, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Andin Hoti, Faton Topalli dhe Albert Kinolli.

Munguan: Zafir Berisha dhe Blerim Kuqi.

Stafi mbështetës i komisionit: Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Mentor Hyseni - GIZ, Rita Ismajli - Demokracia Plus, Valmira Ismaili - Demokracia Plus, Albert Krasniqi – KDI dhe Dren Ajeti-GLPS.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.10.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2016;
4. Diskutim për caktimin e shortit lidhur me Auditimin e Raporteve Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së subjekteve politike, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.10.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 12.10.2017, u miratua pa vërejtjeje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2016

Kryetari theksoi se bazuar në LMFP, kërkohet që Raporti Vjetor i Auditimit të shqyrtohet në komision, e më pastaj në Seancë Plenare para datës 31 tetor 2017, në të kundërtën llogaritet si i aprovuar në formën e dorëzuar. Prandaj bazuar në bazën ligjore të cekur më lartë kërkoi që sot të vendosmi se si ta procedojmë më shpejt për Seancë Plenare.

Faton Topalli shtoi se për shkak të kohës së shkurtër për të diskutuar raportin në detaje propozoi që ne ta adresojmë, si komision për Seancë Plenare dhe atje të vazhdojmë me diskutimin dhe nxjerrjen e rekomandimeve.

Shqipe Pantina theksoi se është mirë që ne të vendosmi që Raporti Vjetor i Auditimit të procedohet për Seancë Plenare dhe kjo e fundit të vendos për miratimin apo jo të raportit. Diskutimi për përmbajtjen e raportit mund të diskutohet edhe në komision, po për shkak të kohës së shkurtër mendoj se ky diskutim mund të bëhet edhe në Seancë Plenare.

Avdullah Hoti theksoi se nga praktika e kaluar raporti i Auditimit fillimisht është diskutuar në komision dhe pastaj së bashku me rekomandimet e dala nga komisioni është adresuar për Seancë Plenare, pastaj nga kjo Seancë ka vendosur që Qeverisë së Republikës së Kosovës t'i caktojë një afat kohor prej 45 dite për hartimin e një plani të veprimit për adresimin e rekomandimeve. Prandaj propozoj që ne, sot, ta aprovojmë raportin si të tillë dhe ta adresojmë për Seancë Plenare.

Mërgim Lushtaku theksoi se për shkak të rëndësisë së raportit është mirë që ky raport të diskutohet mirëfilli në Komision dhe pastaj të adresohet për Seance Plenare. Të përgatisim rekomandimet si komision dhe këto të bëhen bashkërisht me Auditorin e Përgjithshëm.

Alber Kinolli theksoi se Komisioni duhet të dalë me një rekomandim, në të kundërtën nuk mundet me adresuar raportin në seance plenare pa ndonjë rekomandim konkret.

Kryetari, pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar për këtë pikë, propozoi këtë rekomandim të cilin edhe e hodhi në votim si vijon: Të miratohen Rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA- së) së bashku me Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2016. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afat prej 30 ditëve të dorëzojë në Kuvend planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së. Komisioni, kërkon nga Kryesia e Kuvendit që të ftojë Auditorin e Përgjithshëm, për të prezantuar, në mbledhje plenare të Kuvendit, Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2016.

Përfundim

KMFP vendosi që raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2016 ta përkrah si të tillë dhe të njëjtin ta adresoi për Seancë Plenare së bashku me këto rekomandime: a)Të miratohen Rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA- së) së bashku me Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2016. b)Qeveria e Republikës së Kosovës, në afat prej 30 ditëve të dorëzojë në Kuvend planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së. c)Komisioni, kërkon nga Kryesia e Kuvendit që të ftojë Auditorin e Përgjithshëm, për të prezantuar, në mbledhje plenare të Kuvendit, Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2016.

4. Diskutim për caktimin e shortit lidhur me Auditimin e Raporteve Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së subjekteve politike, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016

Kryetari, i njoftoi deputetët dhe të pranishmit se Administrata e Kuvendit ka arritur të përzgjedh operatorin ekonomik për auditimin e raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016. Aktualisht nga ne, si komision funksional, kërkohet të bëjmë tërheqjen e shortit se cili auditorë do të audiojë cilin subjekt politik dhe për cilin vit. Kjo përgjegjësi i takon komisionit bazuar në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike. Me këtë hapi diskutimin.

Faton Topalli theksoi se edhe në legjislaturën e kaluar jemi mundura me e realizuar, megjithatë nuk kemi arritur të përzgjedhim operatorin ekonomik për realizimin e kësaj objekteve. Nuk ka pengesa ligjore për implementimin e kësaj dispozite të përcaktuar me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.

Avdullah Hoti theksoi se KMFP nuk ka nevojë të ngutet me këtë proces, duhet të shikohet mirë baza ligjore se cila është përgjegjësia e Komisionit. Po ashtu kërkoi që komisioni të ketë dokumentet mbi të cilat është vendosur për t'u përgatitur referencat dhe raportin e komisionit të vlerësimit të ofertave. Po ashtu theksoi se cili ishte kriteri që është vendosur që të fillohet nga viti 2013. Po ashtu neni 10 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike thotë se që në muajin janar të secilit vitit fiskal KMFP duhet të bëjë përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve për auditimin e raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike, andaj pyeti pse është pritur kaç gjatë për këtë?

Shqipe Pantina theksoi se deri në vitin 2013 raportet financiare të subjekteve politike janë audituar me kompani të auditimit, mirëpo përzgjedhjen e tyre e ka bërë KQZ- ja. Me ndryshimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike kjo përgjegjësi është bartur te Kuvendi. Auditimi duhet të bëhet që nga viti 2013, ku raportet financiare kanë mbetur të pa audituara, ashtu siç është përcaktuar me kushtet e kontratës. Po ashtu theksoi se raportet financiare duhet të ruhen nga subjektet politike për një periudhë afatgjate, mendojë se ne, si komision, nuk duhet të humbim kohë por të vazhdojmë me tërheqjen e shortit.

Arbër Hoti theksoi se nëse Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në bazë të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike ka përfunduar të gjitha procedurat për sa i përket auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike, atëherë mendoj se duhet të vazhdojmë me tërheqjen e shortit dhe ky proces të përfundojë në tërësi.

Avdullah Hoti theksoi se meqenëse është vullneti i shumicës së deputetëve për të vazhduar me këtë proces, edhe pse jo edhe aq teknik siç po prezantohet këtu. Pajtohem që me short të vazhdohet për takimin e radhës, por me kusht që NE të kemi në dispozicion tërë materialin, mbi të cilin është vendos të bëhet një kontratë me operatorin ekonomik të cekur me lart. Mendojë se KMFP duhet ta ketë vendimin e komisioni vlerësues përzgjedhës për operatorin ekonomik. Si dhe të saktësohet se Auditorët e angazhuar në këtë kompani audituese të mos jenë edhe në marrëdhënie pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit?

Arbër Hoti theksoi se KMFP nuk duhet të jetë përgjegjës për zbatimin e aspektit teknik të përzgjedhjes së operatorit ekonomik. Në këtë rast KMFP duhet të orientohet vetëm në tërheqjen e shortin, se cili auditor duhet të auditojë cilin subjekt politik dhe për cilin vit.

Kryetari theksoi se nëse ekziston vullneti NE shortin mund ta tërheqim brenda kësaj jave, por jo sot për arsye se nuk i kemi të ftuar përfaqësuesit e kompanisë audituese, përfaqësuesit nga KQZ-ja etj. Megjithatë propozoi që me short të vazhdohet për datën 19.10.2017 duke filluar në orën 10.00. Po ashtu kërkoi nga administrata e komisionit që të gjithë materialin lidhur me dosjen e tenderit ta kenë deputetët në kuti postare qysh sot me kusht që të kenë mundësi për të analizuar në detale tërë materialin. Pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar në këtë pikë e hodhi në votim këtë propozim.

Përfundim

KMFP, vendosi që tërheqja e shortit për auditimin e raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitin 2013, 2014, 2015 dhe 2016 të bëhet të enjten më 19.10.2017. Obligohet administrata e KMFP për përgatitjen e të gjitha procedurave teknike, që ky proces të zbatohet në tërësi sa i përket pjesës së komisionit.

5.Të ndryshme

Kryetari njoftoi deputetët se Zyra Kombëtare e Auditimit sot nga ora 11.30 ka ftuar deputetët e komisionit për të marrë pjesë në një takim, ku janë pjesëmarrës edhe përfaqësuesit e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Me këtë mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj